



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTJA
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - PRESEDNICA



THIRRJE PËR NOMINIME NGA OSHC-TË PËR PËRFAQËSUES TË SHOQËRISË CIVILE NË KËSHILLIN PËR DEMOKRACI DHE TË DREJTA TË NJERIUT

THIRRJA ËSHTË E HAPUR PËR 3 PËRFAQESUES TË SHOQËRISË CIVILE

Në kuadër të edicionit të parë të Samitit për Demokraci të organizuar nga Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, institucionet e Republikës së Kosovës kanë marrë një serë zotimesh drejt avancimit të demokracisë në Kosovë. Përmes këtyre zotimeve, institucionet e vendit janë angazhuar për:

1. Luftim të korrupsionit
2. Mbrojtje nga autoritarizmi
3. Avancim të të drejtave të njeriut

Me qëllim të koordinimit dhe menaxhimit sa më të suksesshëm të punës në drejtim të përmbushjes së zotimeve, Presidentja Vjosa Osmani ka iniciuar themelimin e Këshillit për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut. Këshilli do të luaj rol in e mekanizmit përgjegjës për udhëheqjen dhe garantimin e mbarëvajtjes së punës së të gjitha institucioneve të cilat janë drejtpërdrejt përgjegjëse për përmbushjen e zotimeve të prezantuara në Samitin për Demokraci. Për më tepër, Këshilli do të jetë përgjegjës për të garantuar monitorimin, transparencën, dhe llogaridhënien në lidhje me përmbushjen e këtyre zotimeve.

Në këtë kontekst, përveç përfaqësuesve të institucioneve relevante dhe përgjegjëse për zbatimin e zotimeve, të udhëhequr nga Presidentja e Republikës së Kosovës, është shumë e rëndësishme të sigurohet edhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Duke konsideruar rëndësinë e përmbushjes së këtyre zotimeve për avancimin e demokracisë në vend dhe duke synuar gjithnjë gjithëpërfshirjen, përfshirja e organizatave të shoqërisë civile të nivelit qendror dhe lokal në Këshill është e domosdoshme dhe luan një rol kyç drejt garantimit të funksionimit të mirëfilltë të Këshillit. Për këtë Sekretariati i CiviKos do të lehtësojë procedurat e përzgjedhjes së organizatave dhe individëve sipas Rregullores së Punës të CiviKos, në përputhje me kriteret e përcaktuara më poshtë.

Vlen të theksohet se pjesëmarrja e përfaqësuesve të shoqërisë civile parashihet në të dy nivelet e punës së këtij Këshilli – në nivelin e lartë dhe në grupet punuese e tematike. Përmes kësaj thirrje do të bëhet vetëm përzgjedhja e tre (3) përfaqësuesve të shoqërisë civile që do të jenë anëtarë të rregullt të Këshillit. Informacioni mbi përzgjedhjen e anëtarëve që do të jenë pjesë e grupeve punuese do të komunikohet drejtpërdrejt nga Këshilli për Demokraci dhe të Drejtat të Njeriut në muajt në vijim.

Kriteret

Përmes këtij procesi të hapur dhe gjithëpërfshirës, do të përzgjidhen tre (3) persona, të cilët do të shërbejnë si përfaqësues të shoqërisë civile në Këshillin për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut. Secili përfaqësues i përzgjedhur do të jetë përgjegjës për angazhim dhe kontribut në njëren prej 3 objektivave kryesore që ndërlidhen me zotimet e Republikës së Kosovës në kuadër të Samitit për Demokraci.

1. Përfaqësuesi i OJQ-ve **në fushën e luftimit të korrupsionit** duhet të vijë nga një organizatë e cila është:
 - Aktive më shumë se shtatë (7) vite në sektorin e shoqërisë civile; dhe ka aktivitet të dëshmuar në të paktën dy (2) nga fushat në vijim:
 - a. Aktive në fushën kundër korrupsionit;
 - b. Aktive në fushën e promovimit të transparencës institucionale;
 - c. Aktive në fushën e llogaridhënies së institucioneve publike;
 - d. Aktive në fushën e promovimit të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje;
2. Përfaqësuesi i OJQ-ve **në fushën e mbrojtjes nga autoritarizmi** duhet të vijë nga një organizatë e cila është:
 - Aktive më shumë se shtatë (7) vite në sektorin e shoqërisë civile; dhe ka aktivitet të dëshmuar në të paktën dy (2) nga fushat në vijim:
 - a. Aktive në fushën e lirisë së zgjedhës dhe monitorimit të mbarëvajtjes së procesit të zgjedhjeve në Kosovë;
 - b. Aktive në fushën e promovimit të lirisë së medias dhe mbrojtjes së integritetit të informacionit;
 - c. Aktive në fushën luftimit të lajmeve të rreme;
 - d. Aktive në fushën e monitorimit, hulumtimit dhe analizës së politikave në fushën e politikës së jashtme;
 - e. Aktive në fushën e politikave të sigurisë kombëtare dhe/apo asaj kibernetike;

3. Përfaqësuesi i OJQ-ve **në fushën e avancimit të të drejtave të njeriut** duhet të vijë nga një organizatë e cila është:
 - Aktive më shumë se shtatë (7) vite në sektorin e shoqërisë civile; dhe ka aktivitet të dëshmuar në të paktën dy (2) nga fushat në vijim
 - a. Aktive drejt fuqizimit të gruas dhe pozitës së saj në shoqëri;
 - b. Aktive në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut;
 - c. Aktive në fushën e llogaridhënies së institucioneve publike në drejtim të garantimit të drejtave themelore të njeriut;
 - d. Aktive në fushën e luftimit të dhunës në familje dhe/apo dhunës në baza gjinore.

Personat e propozuar për të shërbyer si përfaqësues në cilëndo nga këto fusha, duhen të kenë të paktën pesë (5) vite përvojë në fushën për të cilën propozohen si përfaqësues.

OJQ-të aplikuese dhe personat e nominuar duhet të dëshmojnë aktivitetin e tyre në fushat specifike përmes dëshmimeve konkrete të aktiviteteve të ndërmarra nga ta përgjatë punës (raporte, publikime, lajme, linqe apo dëshmi të tjera të aktivitetit).

Për të nominuar një kandidat/e, OSHC-ja duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

1. CV të kandidatit/es që organizata e nominon;
2. Certifikatën e regjistrimit të organizatës;
3. Dëshmi rreth misionit dhe përvojës së organizatës (jo më shumë se 1 faqe A4)
4. Një dokument që përmbledh aktivitetin e organizatës dhe të individit në fushën përkatëse në tre (3) vitet e fundit;
5. Dëshmitë tjera të aktivitetit në fushën përkatëse. Nëse dëshmia e aktivitetit specifik është e qasshme online, mjafton që të ofrohet linku përkatës.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen përmes email: info@civikos.net, ose në zyret e Platformës CiviKos Rr. Bedri Pejani 7/A 10000 Prishtinë.

Afati për dorëzimin e dokumenteve është data 30.03.2022, ora 16:00.

SHENIM: Kjo thirrje është e hapur për të gjitha organizatat e shoqërisë civile të regjistruara në Kosovë dhe nuk limitohet në anëtarësinë në Platformën CiviKos.

Procedura e votimit për anëtarët

Në rast se kemi më shumë se një (1) kandidat që i plotësojnë kriteret atëherë do të shkohet me procedura të votimit, sipas Rregullores së Punës së CiviKos. Kandidatët që marrin më së shumti vota do të përzgjidhen anëtarë të Këshillit për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut.

Pas përfundimit të nominimit, paneli i përbërë nga një përfaqësues i Sekretariatit të Platformës CiviKos, një anëtar i Bordit të CiviKos dhe një përfaqësues i ZPRK-së do të verifikojë nëse kandidatët e nominuar i plotësojnë kriteret e kërkuara. Të gjithë kandidatët që konstatohet që i plotësojnë kriteret e kërkuara do të përfshihen në listën përfundimtare për votim.

Menjëherë pas përpilimit të listës përfundimtare për votim, të gjitha OShC-të e regjistruara mund të votojnë për kandidatët e tyre të preferuar brenda një afati prej pesë (5) ditësh nga hapja e procesit të votimit. Votuesit mund të hedhin votën e tyre me email, postë të rregullt ose personalisht në zyrën e CiviKos. Votuesit mund të votojnë në mënyrë anonime me hedhjen e votës së tyre në kutinë e votimit në zyrën e CiviKos-it. Në cilëndo mënyrë të votimit, fletëvotimit duhet t'i bashkëngjitet edhe kopja e certifikatës së regjistrimit të organizatës.

Procesi i votimit do të organizohet dhe menaxhohet nga një komision i përbërë nga personeli i Sekretariatit të Platformës CiviKos. Pas zgjedhjeve, Komisioni shqyrton dhe numëron fletëvotimet dhe përcakton se cili(a) kandidat(e) ka marrë numrin më të madh të votave. Nëse dy (2) kandidatë marrin numrin e barabartë të votave, vendi si përfaqësues i OShC-ve do të përcaktohet me short në mes tyre.

Për të reflektuar diversitetin shoqëror dhe të shoqërisë civile në Kosovë, inkurajohet nominimi i grave, anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë dhe grupeve të nënpërfaqësuar.